

FJALA E DEPUTETES ENSLEMLIVERA ZAKE

E ENJTE 20 TETOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin shtesë për projektin e zhvillimit të integruar urban dhe turizmin” në shumën prej 30 milionë eurosh është pjesë e strategjisë afatgjatë të qeverisë shqiptare për të gjallëruar ekonominë vendore dhe jetën komunitare përmes një vëmendje të shtuar drejt turizmit dhe zhvillimit urban. Më herët Kuvendi ka miratuar një marrëveshje të parë huaje me Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që quhet marrëveshja bazë, në shumën 63,8 milionë euro, e cila ka financuar projekte të shpërndara në disa bashki të vendit.

Lidhur me ecurinë e deritanishme të projekteve të financuara nga marrëveshja e parë, për t’u dhënë përgjigje edhe kolegëve Zhupa dhe Agalliu, përgjigje të cilat i kemi marrë edhe në Komisionin e Ekonomisë, por, me sa duket, ose kanë qenë të pavëmendshëm, ose nuk kanë qenë prezentë fare, ato janë të prekshme nga të gjithë ne, pasi janë ndërhyrje që janë bërë në bashki të vendit. Ato janë: rehabilitimi i rrugës me kalldrëm në Qafën e Pazarit në Gjirokastrë, si dhe ndriçimi i kësaj zone; sheshi “Çerçiz Topulli” po në Gjirokastrë; në qytetin e Sarandës kemi shkallaret, si dhe sheshin në shëtitoren “Naim Frashëri”, pra shëtitorja bregdetare; në Berat kemi rruga këmbësore “Mihal Grameno” që të çon te kalaja e Beratit, gjithashtu dhe shtrimi i rrugës automobilistike, e cila të jep akses për të kaluar në kalanë e Beratit; në Përmet kemi ndriçimin e rrugëve hyrëse dhe në Korçë restaurimin e pazarit. Këto janë projekte që janë në fazën *fast track*, pra është lista e projekteve fillestare. Ndërsa projektet në zbatim në fazën e dytë, pra në kontraktim, momentalisht janë: përmirësimi i integruar urban në qytetin e Sarandës, pra ndërhyrje infrastrukturore mes lagjeve të qytetit; zbatimi i masave paraprake për parandalimin e humbjes së trashëgimisë kulturore në kalanë e Gjirokastrës, pra restaurimi i skarpatit anësor i kalasë, përmirësimi i shtegut të “Ali Pashës”, si dhe pastrimi e rehabilitimi i plotë i territorit të kalasë. Gjithashtu, është krijuar edhe një produkt i ri i muzeve, duke ndërtuar një sistem për përmirësimin dhe identifikimin e muzeve, i cilësuar si qyteti i muzeve, ku janë identifikuar 19 muze; është krijuar koncepti i përmbajtjes së këtyre muzeve. Ashtu siç tha edhe ministrja, tashmë ka përfunduar muzeu etnografik në Gjirokastrë dhe muzeu “Ismail Kadare”. Aktualisht po bëhen ndërhyrje në sheshin “Çerçiz Topulli” dhe në parkimin nëntokësor të Gjirokastrës, që është një financim i integruar, pra i ndërthurur mes fondeve të Bankës Botërore dhe buxhetit të shtetit. Për transparencë, këto projekte përbëjnë 65% të financimit nga marrëveshja bazë dhe janë disbursuar 35% të tyre. Këto janë fondet dhe janë paguar 35% e tyre.

Aktualisht janë evidentuar 6 pole për zhvillimin turistik, të cilat janë financuara nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës dhe buxheti i shtetit. Kemi projektin që po implementohet në disa bashki në rajonin bregdetar, i cili përfshin zonën Vlorë – Sarandë dhe zonat më në brendësi që janë Berati, Gjirokastra dhe Përmeti, të cilat janë subjekt i kësaj huaje që po shqyrtojmë dhe do të miratojmë sot në vlerën 30 milionë euro. Këto rajone janë përcaktuar si prioritare, që mbartin potenciale konkrete si nga ana e peizazhit, ashtu edhe nga ana e aseteve kulturore për të zhvilluar turizmin, si një shtysë për nxitjen e rritjes ekonomike rajonale, rrjedhimisht edhe kombëtare.

Nëpërmjet projektit të propozuar synohet të akordohet shtesa e financimit në masën 30 milionë euro, me qëllim financimin e komponentëve që kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës në qytete, si: Berati, Gjirokastra, Përmeti dhe Saranda, duke përgatitur studime fizibiliteti për projektet urbane dhe duke kryer punime ndërtimore për restaurimin e trashëgimisë kulturore, si dhe për zhvillimin e qendrave turistike, me qëllim përmirësimin e këtyre qendrave përgjatë korridorit turistik të Shqipërisë së Jugut, nëpërmjet restaurimit të aseteve të trashëgimisë kulturore, krijimit të pikave të pushimit dhe pikave panoramike, përmirësimin e infrastrukturës së zonave dhe shtigjeve të këmbësorëve, planeve të menaxhimit për destinacionet turistike dhe projektet inxhinierike. Gjithashtu, do t'u vihet në ndihmë edhe bashkive nëpërmjet forcimit të kapacitetit të tyre për përmirësimin e menaxhimit të shërbimeve, mbështetjes së turizmit dhe zhvillimit të produkteve.

Vlera e financimit shtesë, që do të bëjë të mundur përfundimin e këtij projekti, parashikohet të vihet në shfrytëzim më 31 korrik të vitit 2025. Ky projekt konsiderohet si pjesë e dokumentit "Agjenda 2030" për zhvillimin e 17 objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, që janë miratuar nga Asambleja Kombëtare e Përgjithshme e OKB-së, dhe është fokusuar për realizimin e këtyre 2 objektivave.

Së pari, nxitjen e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimin e plotë, produktiv dhe të denjë për të gjithë.

Së dyti, ndërtimin e infrastrukturave rezistuese, nxitjen e industrializimit gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm dhe nxitjen e inovacionit. Ky projekt është parashikuar në projektbuxhetin afatmesëm të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, i cili është organi përgjegjës që ka detyrimin për zbatim. Termat e huas janë: vlera është 30 milionë euro, interesi është bazuar në normën e referencës, plus marzhin e ndryshuar ose sipas normës së përcaktuar të konvertimit, tarifa "*front end fee*" është 0,25% e shumës së huas, komisioni i angazhimit është 0,25% dhe përlllogaritet mbi vlerën e padisbursuar të huas. Afati i maturimit është 16 vjet pa pagesë principali në 4 vjetët e para.

Në përfundim, meqenëse objektivat e projektit lidhen me përmirësimin e infrastrukturës vendore, rritjen e vlerës së aseteve turistike, si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe social, që lidhen me sektorin e turizmit; meqenëse këto investime quhen projekte të kategorisë B, që nënkupton se ndërhyrjet e ndërmarra nuk do të kenë ndikim të pakthyeshëm social dhe mjedisor, në mënyrë që të përfundojnë sa më shpejt këto projekte dhe t'i kemi të prekshme që të shfrytëzohen nga të gjithë, i ftoj kolegët ta miratojnë, sepse Shqipëria është e të gjithëve. Faleminderit!